REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 299, Datë 20.10.2026

MBI

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 174, DATË 29.08.2024 "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "FAETHON" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrik*e*"*, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*"; si dhe nenit 15, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3074 prot., datë 14.10.2026, të përgatitur nga Drejtori e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës *"Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024 "Mbi licencimin e shoqërisë "FAETHON" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike" i ndryshuar",*

Konstatoi se:

1. **Të dhëna mbi shoqërinë "FAETHON" sh.p.k.**

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 104, datë 31.05.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Në vijim, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 29.08.2024, i ndryshuar me vendimin nr. 317, datë 12.12.2025, vendositë licencojë shoqërisë "FAETHON" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 MW AC, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastër, për një afat 25-vjeçar.
- Në pikat 2 dhe 3 të vendimit 174/2024 i ishte lënë detyrë shoqërisë për të filluar ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, jo më vonë se data 14.02.2027, si dhe për të depozituar në ERE një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Ndërsa në pikën 4 ishte përcaktuar se ky vendim është objekt rishikimi.
- Më tej, në rrethanat kur nga ana e shoqërisë nuk rezultoi të ishte depozituar brenda afatit sa lënë detyrë në pikën 3 të vendimit nr. 174/2024, të ndryshuar, dhe centrali nuk ishte ndërtuar ende, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 151, datë 28.05.2026, vendosi të pezullojë vendimmarrjen për licencimin e shoqërisë "FAETHON" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 MW AC, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastër, deri në depozitimin në ERE të VNM-së Paraprake të re, por jo më vonë se data 14.09.2026, duke marrë në konsideratë edhe kohën e nevojshme për ndërtimin dhe vënien në operim të centralit brenda afatit 14.02.2027. Me këtë vendim u shfuqizuan gjithashtu pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 174/2024, të ndryshuar, përkatësisht pika 2, që lidhej me fillimin e operimit të centralit, dhe pika 3, detyrimi i së cilës për depozitimin e dokumentacionit mjedisor u integrua në përmbajtjen e re të pikës 1 të vendimit.

2. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin nr. 151/2026 me shkresën nr. 1696/1 prot., datë 10.06.2026, duke i kërkuar që të mbajnë në konsideratë për të depozituar këtë dokument brenda afatit të përcaktuar. Po ashtu, me shkresën nr. 1696/1 prot., datë 10.06.2026, është njoftuar për këtë vendimmarrje përkatësisht dhe MIE, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a..
- Nga ana e shoqërisë nuk është depozituar në vijim as informacion dhe as dokumentacion për sa lënë detyrë.
- Për sa më sipër, vlerësohet se jemi në rrethanat e rishikimit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, të ndryshuar, në përputhje me pikën 4 të tij, ku përcaktohet se ky vendim është objekt rishikimi, pasi shoqëria nuk ka përmbushur detyrimin për depozitimin e dokumentacionit mjedisor të kërkuar brenda afatit të përcaktuar.
- Pavarësisht njoftimit zyrtar të kësaj vendimmarrjeje dhe afatit të përcaktuar, shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar dhe as nuk ka paraqitur informacion apo shpjegime lidhur me pamundësinë e përmbushjes së këtij detyrimi. Në këto kushte, mosveprimi i shoqërisë edhe pas pezullimit të procedurës dhe dhënies së një afati shtesë për plotësimin e dokumentacionit, nuk mund të justifikojë vijimin e një procedure licencimi në mungesë të dokumentacionit të kërkuar si kusht për vijimin e saj.
- Për rrjedhojë, në kushtet kur afati i përcaktuar ka përfunduar pa u përmbushur detyrimi dhe nuk rezulton të jenë paraqitur elemente të reja që të justifikojnë vijimin e procedurës, vlerësohet se ekzistojnë shkaqe të mjaftueshme për rishikimin e vendimit nr. 174, datë 29.08.2024, të ndryshuar, dhe refuzimin e kërkesës së shoqërisë "FAETHON" sh.p.k. për licencim, për shkak të mosplotësimit brenda afatit të dokumentacionit të kërkuar.

3. Nevoja për rishikimin e vendimit

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"* parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi kompetent me një akt të ri me shkrim.
- Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve si më sipër të vendimit nr. 174/2024, i ndryshuar, dhe me refuzimin e kërkesës së shoqërisë për licencim, licenca dhe çdo akt tjetër i dalë në zbatim të tij bëhen të pavlefshme.
- Për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga ky central, shoqëria duhet të paraqesë një aplikim të ri për licencim pranë ERE-s, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, si vijon:
   a) Pika 1 e vendimit, ndryshon dhe bëhet:

   1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë "FAETHON" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 78.6 MW AC, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastër.

   b) Pika 4 e vendimit, shfuqizohet.

2. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve si më sipër, licenca dhe çdo akt tjetër i dalë në zbatim të tij bëhen të pavlefshme.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës, të njoftojë shoqërinë "FAETHON" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" sh.a., shoqërinë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. dhe shoqërinë "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" (ALPEX) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI